

## Vendim nr. 131 datë 10.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 10.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **KASTRIOT FEJZO**, përfaqësuar nga avokat Spartak Ngjela, me prokurë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2021-691, datë 23.02.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 57, datë 15.04.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2023-1466, datë 21.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31, pikat “a”, “b”, “ç” dhe “d”, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë ka regjistruar procedimin penal nr. 29/1/1, datë 18.12.2000 ndaj disa të pandehurve dhe kërkuesit Kastriot Fejzo për veprat penale “Vrasja me paramendim”, e kryer në bashkëpunim ndaj dy personave, “Vrasja me paramendim”, në bashkëpunim e mbetur në fazën e tentativës”, e kryer ndaj 5 personave, të parashikuara nga nenet 78/2, 25, 78/2, 25 dhe 78/2, 22 e 25 Kodit Penal (KP), të ndryshuar.

2. Gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit. Në seancën gjyqësore të datës 17.04.2001 ka rezultuar se disa prej të pandehurve, mes të cilëve edhe kërkuesi, ishin me vendqëndrim jashtë shtetit. Në seancën e datës 30.04.2001 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kolonjë ka deklaruar mungesën e të pandehurit Kastriot Fejzo dhe i ka caktuar atij një mbrojtës kryesisht, avokatin F.C., i cili ka kërkuar deklarin të pafajshëm të kërkuesit. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kolonjë, me vendimin nr. 18, datë 13.12.2002, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Kastriot Fejzo për kryerjen e veprës penale të vrasjes së mbetur në tentativë, të kryer në bashkëpunim, bazuar në nenet 78/2, 22 e 25 të KP-së. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të KP-së, kërkuesi është dënuar me 21 vjet burg.

3. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 51, datë 16.04.2003, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë dhe kthimin e akteve në atë gjykatë, duke arsyetuar se për shkak të karakterit tepër të veçantë e të komplikuar të çështjes duhej të ishin bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar pjesëmarrjen e të pandehurve. Sipas asaj gjykate, edhe pjesëmarrja e avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht ka mbetur tepër formale, për shkak të mungesës së kontaktit të tij me të pandehurin. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë, duke pretenduar se vendimi i gjykatës së apelit është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në materialet e dosjes, pasi në kushtet që gjykimi i çështjes ka vazhduar për rreth 1 vit në gjykatën e rrethit, ku të pandehurit janë banorë, dhe me gjithë kërkimet e bëra nga ajo gjykatë nuk është bërë e mundur gjetja e tyre, kjo do të thotë se ata i janë fshehur qëllimisht gjykimit.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 70, datë 04.02.2004, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e akteve për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykata e apelit nuk ka kontrolluar dhe verifikuar me saktësi veprimtarinë ligjore të gjykatës së shkallës së parë, nuk i ka trajtuar me kujdes fletëthirrjet dhe raportet e shërbimit, nga duket qartë se për shkak të largimit të të pandehurve ose ndryshimit

të vendbanimit në rrethe të tjera nuk është bërë i mundur njoftimi i tyre, pasi vetë ata i janë shmangur gjykimit.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 27, datë 23.02.2006, në përfundim të gjykimit ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit dhe dënimin e tij me 20 vjet burg për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 79, shkronja “dh” dhe 25 të KP-së. Në këtë gjykim kërkuesi është mbrojtur nga avokati Gj.Gj., i caktuar kryesisht nga gjykata. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs prokuroria dhe mbrojtësi i kërkuesit.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 10.01.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit dhe ndryshimin e vendimit për sa i përket kualifikimit ligjor të veprës dhe në bazë të neneve 78/1 dhe 25 të KP-së, midis të tjerave, ka vendosur dënimin e kërkuesit Kastriot Fejzo përfundimisht me 18 vjet burgim. Kolegji Penal i ka gjetur të pabazuara pretendimet e ngritura në rekurs për shkeljen e dispozitave për njoftimin e kërkuesit, duke vlerësuar se jo vetëm që nuk rezultojnë të tilla shkelje, por se është provuar se ai ka marrë dijeni për gjykimin e çështjes në ngarkim të tij, është thirrur në gjykim dhe është përfaqësuar me mbrojtës të caktuar në format e parashikuara nga ligji.

7. Në datën 15.01.2020 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr. 18, datë 13.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë, bazuar në nenin 420/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), duke pretenduar se nuk ka marrë dijeni efektive për vendimin penal nr. 18, datë 13.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë. Në lidhje me këtë kërkesë, prokurori ka prapësuar se kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin gjyqësor të formës së prerë nr. 27, datë 23.02.2006 të Gjykatës së Apelit Korçë, provuar kjo edhe nga prokura e posaçme nr. 581 rep., nr. 254 kol., datë 26.02.2006 hartuar përpara noteres Zh.M., ku i dënuari Kastriot Fejzo i ka dhënë tagra avokatit N.T. për të ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kjo prokurë është përdorur nga avokati N.T. gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-691, datë 23.02.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas kësaj gjykate, në lidhje me vendimin për të cilin kërkohet rivendosja në afat janë shprehur njëherë gjykatat më të larta dhe, po ashtu, duke qenë se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të disa të bashkëpandehurve të tjerë, edhe sikur të merret i mirëqenë pretendimi i kërkuesit se ai nuk ka ushtruar ankim (bazuar në pretendimet e tij për falsitet të prokurës së posaçme me të cilën i ka dhënë tagra përfaqësimi avokatit N.T. për të ushtruar në

emër të tij rekurs në Gjykatën e Lartë), nuk ka vend për pranimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

9. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 57, datë 15.04.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke arsyetuar se ai është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit dhe se shkaqet e ngritura në ankim nga kërkuesi nuk gjejnë mbështetje ligjore. Kundër këtij vendimi kërkuesi, nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatave të faktit dhe pranimin e kërkesës për rivendosje në afat.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1466, datë 21.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke vlerësuar se asnjë nga pretendimet e ngritura në të nuk u referohet shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të parashtruara në ankim nga mbrojtësi i kërkuetit, duke e argumentuar vendimmarrjen e saj dhe nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit penal material ose procedural me rëndësi për njësimin apo zhvillimin e praktikës gjyqësore, nuk evidentohen shkaqe që lidhen me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit dhe pavlefshmërinë absolute të akteve apo papërdorshmërinë e provave, si dhe nuk evidentohet që vendimi i kundërshtuar të jetë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

11. Në datën 09.04.2024 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij.

## II

### Pretendimet e kërkuetit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ndaj tij nuk është zhvilluar një proces i rregullt ligjor, duke iu cenuar:

12.1. *E drejta për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuesi nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor penal ndaj tij dhe të dënimit, duke qenë se është gjykuar në mungesë. Në momentin kur ka marrë dijeni, ai është vetëdorëzuar përpara organeve ligjzbatuese, në mënyrë që të fillonte mbrojtjen për rrëzimin e akuzave të pavërteta ndaj tij. Që prej vitit 2002 dhe deri në momentin që është vetëdorëzuar, nga aktet e dosjeve gjyqësore nuk është vërtetuar se kërkuesi ka qenë në dijeni të dënimit. Të tria gjykatat kanë gabuar në drejtim të të provuarit të dijenisë së kërkuetit, fakt ky që

plotëson krejtësisht ngarkesën juridike benefciale që i jep nenin 31 i Kushtetutës. Është fakt që kërkuesi ka qenë krejtësisht i lirë edhe pse ka qenë i dënuar me burgim 21 vjet dhe gjatë të gjithë kësaj periudhe, në shumicën e kohës, ka qëndruar në qytetin e Ersekës pa pasur dijeni se mund të ishte i dënuar. Ai ka banuar në shtëpinë e tij normalisht dhe më vonë ka emigruar drejt shtetit grek, por asnjëherë nuk ka qenë në kërkim për kryerjen e dënimit të marrë.

12.2.Prokura e posaçme nr. 581 rep. nr. 254 kol., datë 26.02.2006, e lëshuar në favor të avokatit N.T., është një akt absolutisht i pavlefshëm dhe firma e kërkuesit është e falsifikuar. Ky fakt vërtetohet edhe nga akti i ekspertimit grafik nr. 15, datë 02.09.2020 i ekspertit kriminalist V.H. Avokati N.T. është në armiqësi familjare prej shumë vitesh me kërkuesin. Fakti që kërkuesi nuk ka qenë në dijeni të dënimit e konfirmon edhe prova e pakontestueshme që është një kërkesë me objekt tjetër e paraqitur prej tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kolonjë në vitin 2004, pikërisht në atë gjykatë që e ka dënuar. Gjatë të gjithë procesit penal kërkuesi nuk ka pasur as kohën e mjaftueshme dhe as lehtësinë për të përgatitur mbrojtjen e tij, pasi nuk ka qenë në dijeni të çështjes penale në ngarkim të tij.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

14. Kolegji vlerëson se kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi më i fundit që ka përmbyllur procesin e kundërshtuar nga kërkuesi është ai i Gjykatës së Lartë, i cili mban datën 21.09.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 09.04.2024. Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë për këtë qëllim, evidentohet se vendimi nr. 00-2023-1466, datë 21.09.2023 është publikuar në faqen zyrtare të kësaj Gjykate në datën 28.12.2023, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi edhe pse i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar formalisht vendimet gjyqësore të dhëna në procesin gjyqësor të vënë prej tij në lëvizje, me objekt rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit ndaj vendimit nr. 18, datë 13.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë, pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me procesin gjyqësor të themelit të çështjes ku ai është deklaruar fajtor dhe dënuar, i cili është përmbyllur me vendimin nr. 2, datë 10.01.2007 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkuesit, ai nuk ka pasur dijeni për procesin e zhvilluar në mungesë, për shkak se nuk është njoftuar nga gjykata edhe pse ka qenë i lirë. Sipas kërkuesit, prokura e posaçme nr. 581 rep. 254 kol, datë 26.02.2006, hartuar para noteres Zh.M. për avokatin N.T. ka qenë e falsifikuar, çka provohet nga akti i ekspertimit dhe ky avokat ka pasur probleme dhe është në armiqësi me familjen e kërkuesit.

18. Në lidhje me këtë proces, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-691, datë 23.02.2021, ka argumentuar se duke qenë se për vendimin për të cilin kërkohet rivendosja në afat janë shprehur një herë gjykatat më të larta dhe po ashtu, duke qenë se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të disa të bashkëpandehurve të tjerë, edhe sikur të merret i mirëqenë

pretendimi i kërkuesit se ai nuk ka ushtruar ankim (bazuar në falsitetin e prokurës), gjykata çmon se nuk ka vend për t'u pranuar kërkesa e kërkuesit për t'u rivendosur në afat për të bërë ankim ndaj vendimit gjyqësor penal nr. 18, datë 13.12.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kolonjë (*shih faqen 14 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Korçë*). Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, pasi ka arsyetuar se pavarësisht falsitetit apo jo të prokurës, ky fakt nuk mohon faktin tjetër se çështja është shqyrtuar në themel nga Kolegji Penal, i cili është shprehur edhe për dënimin e kërkuesit (*shih faqen 18 të vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë*). Ndërsa Gjykata e Lartë me vendimin nr. nr. 00-2023-1466, datë 21.09.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin se asnjë nga pretendimet e ngritura nga kërkuesi nuk u referohet shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe nuk konstatohet zbatim i gabuar i ligjit penal material apo procedural me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore (*shih paragrafin 17 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

19. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Për sa më sipër, si dhe referuar pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues nga kërkuesi, Kolegji vlerëson se gjykatat e zakonshme i kanë dhënë atij përgjigje të arsyetuara përse nuk e kanë pranuar kërkesën për rivendosje në afat, duke argumentuar se çështja e kërkuesit është gjykuar në themel dhe se kërkuesi nuk është gjykuar në mungesë në shkallë të parë dhe në apel, pasi është përfaqësuar nga një mbrojtës i caktuar kryesisht, ndërkohë në Gjykatën e Lartë ai është mbrojtur nga përfaqësuesi ligjor i zgjedhur prej tij. Në lidhje me pretendimet për falsitetin e prokurës së posaçme të paraqitur nga mbrojtësi N.T. në procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit ka arsyetuar se nuk rezulton që falsiteti i prokurës të jetë konfirmuar me vendim gjyqësor të formës së prerë (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

21. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat

të ketë qenë arbitrare, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt. Në këtë kuptim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

22. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.